

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI B

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Ekonomi e thelluar

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Buxheti i qeverisë rezulton të jetë i balancuar kur të ardhurat: **1 pikë**
- A) janë më të vogla se shpenzimet
 - B) janë më të mëdha se shpenzimet
 - C) janë të barabarta me shpenzimet
 - D) nuk ndikohen nga doganat.
2. Tregtia ndërkombëtare ka dy anë: **1 pikë**
- A) kërkesa dhe elasticiteti i saj
 - B) ofertën dhe elasticiteti i saj
 - C) eksporti dhe importi
 - D) mjetet dhe burimet
3. Programet e mirëqenies sociale për të luftuar varfërinë NUK përfshijnë: **1 pikë**
- A) ndihmën ekonomike në formën e parave
 - B) ndërtimin e banesave me pronësi publike
 - C) ndihma për familjet me shumë fëmijë
 - D) sigurimet e papunësisë.
4. Kur inflacioni merr vlera negative, atëherë kemi të bëjmë me: **1 pikë**
- A) inflacion të moderuar
 - B) inflacion galopant
 - C) dizinflacion
 - D) deflacion
5. Supozojmë se Riviera depoziton 10 milionë lekë në Bankën B&B. Norma e rezervës së detyruar vendosur nga Banka Qendrore është 10% . Llogaritni sa do të jetë shtesa e ofertës monetare. **1 pikë**
- A) 9 milion
 - B) 10 milion
 - C) 90 milion
 - D) 100 milion
6. Çmimet shërbejnë si burim informacioni: **1 pikë**
- A) vetëm për prodhuesit
 - B) vetëm për konsumatorët
 - C) për prodhuesit dhe për konsumatorët
 - D) as për prodhuesit as për konsumatorët
7. Elasticiteti i tërthortë i kërkesës është -2. Dy të mirat janë plotësuese, pra kërkesa për njërin të mirë _____ kur çmimi i të mirës tjetër _____. **1 pikë**
- A) bie, bie
 - B) rritet, rritet
 - C) bie, rritet
 - D) rritet, bie

8. Nëse GDP-ja nominale është 150% dhe GDP-ja reale është 125%, atëhere vlera e deflatorit do të jetë: **1 pikë**
- A) 1.20
B) 0.80
C) 120
D) 250
9. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon në ofertë? **1 pikë**
- A) shijet dhe preferencat e konsumatorit
B) të ardhurat e konsumatorit
C) çmimi i faktorëve të prodhimit
D) parashikimi i konsumatorëve lidhur me të ardhurat dhe çmimin e mallit
10. Supozojmë që ju keni hapur një llogari kursimi në një bankë tregtare me afat njëvjeçar në shumën 1000 000 lekë, me normë vjetore interesi 5%. Në këto kushte, interesi në lekë do të jetë _____ dhe shuma e parave pas një viti do të jetë _____ **1 pikë**
- A) 70 000 lekë dhe 1 070 000 lekë
B) 60 000 lekë dhe 1 060 000 lekë
C) 50 000 lekë dhe 1 050 000 lekë
D) 40 000 lekë dhe 1 040 000 lekë
11. Shpjegoni tri nga përparësitë e biznesit të vogël. **3 pikë**
- a) _____
b) _____
c) _____
12. Jepni përkufizimin e koncepteve: **3 pikë**
- a) ligj i dobishmërisë marxhinale rënëse _____

- b) elasticitet i të ardhurave _____

- c) sipëmarrje _____

13. Tregoni tre aspekte nga funksioni i prodhimit.

3 pikë

- a) _____
 b) _____
 c) _____

14. Arsyetoni pse elasticiteti i kërkesës për Makina Sportive Range Rover do të rritet, bjerë apo mbetet i njëjtë, në situatat e mëposhtme.

3 pikë

- a) Makina të tjera të tilla si Ford apo General Motors vendosin të prodhojnë e shesin, gjithashtu, në të njëjtin treg makina sportive. _____

- b) Për shkak të taksave të larta firmat të tjera që ofrojnë makina sportive, dalin nga tregu.

- c) Për shkak të rritjes së taksave, çmimi i makinave, e për rrjedhojë kostoja e një makine R.Rover është e konsiderueshme për buxhetin e shqiptarëve. _____

15. Jepet tabela e mëposhtme që paraqet koston e firmës në periudhën afatshkurtër. Nëse firma është në konkurrencë të plotë dhe çmimi i produktit është 22 njësi paraqe:

3 pikë

- a) Gjeni sa do të jetë sasia fitim maksimizuese e firmës. _____

- b) Tregoni situatën ekonomike në të cilën ndodhet firma për këtë sasi fitim maksimizuese.

- c) Tregoni se çfarë duhet të bëjë firma në lidhje me prodhimin. _____

Q	0	1	2	3	4	5	6	7
AFC	-	40	20	13.3	10	8	6.6	5.7
AVC	-	8	8	10	12	14	16.6	18.5

16. Ndërtoni një grafik ku në boshtin OY keni të dhëna koordinatat (0; 20) të cilat paraqesin prodhimin e një produkti industrial. Në boshtin e OX keni të dhëna koordinatat (20; 0) që pasqyrojnë prodhimet bujqësore. Mbështetur në këto të dhëna: **3 pikë**
- a) Ndërtoni kufirin e mundësive të prodhimit të një vendi.
- b) Çfarë tregon një pikë brenda këtij kufiri? _____
- c) Çfarë tregon një pikë jashtë këtij kufiri? _____

17. Jepni nga një shembull për një: **3 pikë**
- a) eksternalitet pozitiv _____
- b) të mirë rivale përjashtuese _____
- c) të mirë rivale jo përjashtuese _____

18. Shpjegoni katër faktorët që e zhvendosin lakoren e kërkesës tërësore djathtas. **4 pikë**
- a) _____

- b) _____

- c) _____

- d) _____

19. Tregoni dy pengesa në tregtinë ndërkombëtare përveç tarifave. **2 pikë**
- a) _____
- b) _____

20. Në modelin kejnsonian të ekuilibrit makroekonomik, lakorja e ofertës tërësore është horizontale.

Nëse AD_1 kalon në AD_2 , gjeni çfarë ndodh me:

3 pikë

a) GDP-në reale _____

b) nivelin e çmimeve _____

c) Bëni paraqitjen grafike të kësaj situate.

